PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit e mbajtur me 22.01.2024-të, me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës.

Seancën e hapi Kryetari i Këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr.arkivor 08-91/1

Para se ta hapte seancën Kryetari i këshillit dha sqarime rreth pikës së parë të rendit të ditës, që për shkaqe të mungesës së materialit kjo pikë të mos merrej parasysh.

REND DITE

1.Miratimi i proçesverbalit të Seancës së24-të, tëKëshillit të komunës së Zhelinës.

2.Propozim-Vendim për shkarkimin dhe emërimin e një anëtari të Këshillit për kryerjen e kontrollit të punës materiale dhe financiare të Ndërmarjes së përbashkët publike Rusino/Pollog.

3.Propozim-Vendim për dhënie Pëlqimi Plani vjetor për punësim të komunës së Zhelinës për vitin 2024-të

4.Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Qershor / 2023-të.

5.Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Shtator / 2023-të.

6.Propozim-Programë për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Zhelinës për vitin 2024-të.

7.Propozim-Programë për përpunim të planeve urbanistike (PU), në teritorin e komunës së Zhelinës për vitin 2024-të.

8.Propozim-Programë për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndriçimit publik si dhe ndërimin e poçave elektrike në teritorin e komunës së Zhelinës për vitin 2024-të.

9.Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim dhe zbatim Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2024-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim për rendin e ditës dhe meqë nuk pati diskutim e hodhi në votim, u votua unanimisht nga të gjithë këshilltarët.

1. Propozim-Vendim për shkarkimin dhe emërimin e një anëtari të Këshillit për kryerjen e kontrollit të punës materiale dhe financiare të Ndërmarjes së përbashkët publike Rusino/Pollog.

   Meqë nuk pati diskutime Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 17 vota të përmbajtur, asnjë për dhe asnjë kundër me këtë konstatoi se kjo pike nuk kalon.

2. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqimi Plani vjetor për punësim të komunës së Zhelinës për vitin 2024-të.

Kryetari i këshilli hap diskutim fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Kërkoj më shumë informaciome rreth kësaj pike.

Informacionet i dha Dashmir Xhelili.

Pas diskutimeve Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, ku u votua me 8 vota për, asnjë kundër dhe 8 tëpërmbajtur me këtë konstatoi se kjo pike nuk kalon.

3. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Qershor / 2023-të.

   Meqë nuk pati diskutime Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 7 vota për, asnjë kundër dhe 9 të përmbajtur konstatoi se kjo pike nuk kalon.

4. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Shtator / 2023-të.

   Meqë nuk pati diskutime Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 6 vota për, asnjë kundër dhe 9 të përmbajtur, Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pike nuk kalon.

5. Propozim-Programë për rregullimin e tokës ndërtimore në komunën e Zhelinës për vitin 2024-të.

   Meqë nuk pati diskutime Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 1 votë për, asnjë kundër dhe 15 të përmbajtur, me këtë konstatoi se kjo pike nuk kalon.

6. Propozim-Programë për përpunim të planeve urbanistike (PU), në teritorin e komunës së Zhelinës për vitin 2024-të.

   Sqarime për këtë pike kërkoi këshilltari Sheval Sulejmani. Sqarimet i dha Kreshnike Idrizi.

   Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 5 vota për, asnjë kundër dhe 11 të përmbajtur, me këtë konstatoi se kjo pike nuk kalon.

7. Propozim-Programë për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndriçimit publik si dhe ndërimin e poçave elektrike në teritorin e komunës së Zhelinës për vitin 2024-të.

   Meqë nuk pati diskutime Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 7 vota për asnjë kundër dhe 11 të përmbajtur, me këtë konstatoi se kjo pike nuk kalon.

8. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim dhe zbatim Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2024-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.
Sheval S: kërkoi sqarime rreth kësaj pike.
Sqarime dha Suad Alili.
Gjithashtu sqarime kërkuan edhe këshilltarët Naser Mislimi dhe Rian Amiti, poashtu sqarimet i dha SuadAlili.

Pas diskutimeve Kryetari i këshillit këtë pike e hodhi në votim, u votua me 8 vota për, asnjë kundër dhe 5 të përmbajtur, dhe me këtë kryetari i këshillit konstatoi se kjo pike kalon.

Nr. 08-91/2
22.01.2024-të
Zhelinë.

Proçesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i Komunës së Zhelinës
Kryetar,
Bujar Baftijari